

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Irlanda jep dritën jeshile për përballjen me Izraelin pas votimit të lojtarëve
ADRESA	https://albeu.com/sport/irlanda-jep-driten-jeshile-per-perballjen-me-izraelin-pas-votimit-te-lojtareve/1028838/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:43:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:40:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	17c4bea4c23a4d5fffe04c03ba9b21b1ef43b9a7bb20ae857f7cd4930c6c6c97
TEKSTI	f73719482d35d6333ef971eb1cd772305aff51a1db44c2079917dd0422f2c8ae
PAMJA	e2c29b3d58bb297d2f3318f70cb879375850f032905e3603d6bac0d367dabd87

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8716e27937a5f4cbda87dc4686618658f5d00e339544e164f2e0cfa871eeb1a4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8716e27937a5f4cbda87dc4686618658f5d00e339544e164f2e0cfa871eeb1a4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Irlanda jep dritën jeshile për përballjen me Izraelin pas votimit të lojtarëve



Futbollistët e Kombëtares së Irlandës kanë votuar që ndeshja ndaj Izraelit të zhvillohet. Pas bisedimeve të gjata, është vendosur që sfida e Ligës së Kombeve të luhet të dielën në Debrecen.

David Courell, shefi ekzekutiv i Federatës Irlandeze të Futbollit (FAI), bëri të ditur se një prej lojtarëve kishte shprehur shqetësimet e shtunën në mëngjes dhe po shqyrtonte mundësinë për t'u larguar nga grumbullimi.

Debati në Irlandë është nxitur nga ofensiva ushtarake izraelite në Gaza, ndërsa kundërshtimet për zhvillimin e ndeshjeve kundër Izraelit kanë qenë të forta. Në korrik, Federata Irlandeze organizoi një votim pas protestave për bojkotimin e këtyre sfidave. Rezultati ishte 75 vota pro dhe 32 kundër, duke i hapur rrugë vazhdimi të pjesëmarrjes së Kombëtares.

Një vendim për të bojkotuar ndeshjen mund ta ekspozonte federatën ndaj sanksioneve të UEFA-s, si dhe ndaj humbjeve të mëdha financiare.

Shqetësimet ishin shprehur edhe nga vetë lojtarët. Mesfushori Jason Knight kishte thënë: "Nuk mendoj se ndeshja duhet të zhvillohet domosdoshmërisht, por ajo po zhvillohet".

Përplasjet dhe diskutimet mes futbollistëve, stafit teknik dhe drejtuesve të federatës sollën shtyrjen e konferencës për shtyp dhe të seancës stërvitore të Irlandës të shtunën. Sipas Courell, në përfundim shumica e qartë e lojtarëve votoi në favor të zhvillimit të ndeshjes.

Përzgjedhësi Heimur Hallgrímsson kishte deklaruar më herët: "Ne nuk po luajmë me gjenocidin, po luajmë kundër gjenocidit. Po luajmë kundër Izraelit dhe nuk po luajmë me Izraelin".

Federata Izraelite e Futbollit iu përgjigj trajnerit irlandez, duke e cilësuar deklaratën e tij si shfaqje të "injurancës, hipokrizisë dhe marrëzisë".

të fundit /



Irlanda jep dritën jeshile për përballjen me Izraelin pas votimit të...



Nisin pagesat për viktimat e rastit të komandantit "Cali"



Protesta kundër vendimit të Hagës, qytetarët nisin tubimi...



Presidenti Duka: Maran është zgjedhja e duhur, nisja me fitore do t'i...



Trump i jep botës "goditjen" e papritur, refuzon hapjen e...



Instituti GAP: Mbi 250 mijë kosovarë u pajisën me leje qëndrimi në...



Kurti: Votimi i vitit 1991 konfirmoi synimin për pavarësi



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ndeshja do të zhvillohet pa ceremoninë tradicionale të shtrëngimit të duarve

Hallgrímsson e përshkroi situatën si "të jashtëzakonshme" dhe tha se synimi ishte "minimizimi i dëmit".

Courell konfirmoi se para fillimit të takimit nuk do të ketë shtrëngim duarsh mes lojtarëve të Irlandës dhe atyre të Izraelit. Gjithashtu, dy skuadrat nuk do të shkëmbejnë flamujt sipas traditës.

Lojtarët irlandezë pritet të mbajnë shirita të zinj në krah, në kujtim të personave që kanë humbur jetën në konfliktin Izrael-Gaza.

Pas duelit në Debrecen, Irlanda do të luajë në shtëpi ndaj Austrisë në Dublin të enjten. Të dielën pasuese, ajo do të përballë përsëri me Izraelin, këtë herë në Serbi.

RTE do t'i transmetojë drejtpërdrejt të dyja ndeshjet ndaj Izraelit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Megjithatë, transmetimet nuk do të shoqërohen me reklama, komentim, analiza nga ekspertët apo analizë gjatë pjesës së parë./

Shtuar më 26.09.2026 20:40

Tags: [Kombëtarja e irlandës](#), [Kombëtarja e izraelit](#),
[Liga e Kombeve](#)



Presidenti Duka: Maran është zgjedhja e duhur, nisja me fitore do t'i japë...



Shqipëria synon fitoren në debutimin e epokës Maran ndaj Bjellorusisë,...



Foda: Synimi i Kosovës mbetet Euro 2028, Tolaj dhe Fazlija mund të...



Vojvoda: Austria ka përvojë, por tifozët shqiptarë do të na japin forcë – flet edhe...



Gani Sejdiu vlerëson përgatitjen taktike të Kosovës në fitoren ndaj...



Foda vlerëson Austrinë si favorite, por pret mbështetje të madhe nga...



Bylisi bind në transfertë, mposht Luftëtarin 3-0 në miqësore



Kosova kryen vizitën në "Ernst Happel" para duelit me Austrinë



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.